

STATUTI I SHOQERISE  
DHE  
AKTI I THEMELIMIT  
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
**“MATRIX.AL” SH.P.K**

Shtetesja Drilona Gerbolli , i lindur me 16.04.1998, ne Matranxh, Kukes, me banim ne Rruga Demokracia 03840112, Nd. 8; H. 1; Kamez, Bathore; 1054; Kamez, identifikuar me ane te Kartes se identitetit J85416104T, madhor me zotesi te plete per te vepruar, nen cilesine e ortakut themelues krijon:

Sot me daten 23 GUSHT 2022, Drilona Gerbolli krijoi Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“MATRIX.AL” SH.P.K**, me seli ne Rruga: Reshit Petrela, Hyrja 3, Apartamenti N16, Tirane.

Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtarë **“MATRIX.AL” SH.P.K**, si dhe zhvillimi i metejshem i saj.

**KREU I**

**NENI 1**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**1.1** Ortaku i Vetem i kesaj shoqerie eshte Znj. Drilona Gerbolli, dhe zoteron 100 % te kapitalit te shoqerise.

**NENI 2**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

**2.1.** Shoqeria mban emrin **“MATRIX.AL” SH.P.K**, dhe eshte person juridik shqiptar.

**2.2.** Kjo shoqeri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**2.3.** Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjisacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontratat respektive.



### **NENI 3**

#### **SELIA E SHOQERISE**

**3.1.** Shoqeria “**MATRIX.AL**” SH.P.K, e ka qendren e selise ne adresen:  
Rruga ‘Reshit Petrela’, Hyrja 3, Apartamenti N16, Tirane.

### **NENI 4**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**4.1.** Objekti i Veprimtarise se Shoqeri eshte :

- Ne Call Center, Shitje telefonike, Sherbim IT, Sherbime Inxhinierike dhe Arkitekture, Konsulencë Juridike, Avokati, etj

**4.2.** Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga ortaku i vetem i saj.

**4.3.** Shoqeria mund te zgjeroje ose kufizoje fushen e veprimtarise se saj ne cdo kohe.

### **NENI 5**

#### **PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM**

**5.1.** Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakut te vetem.

**5.2.** Ortaku i vetem qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte perqejes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk perqigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

### **NENI 6**

#### **KOHEZGJATJA**

**6.1.** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj



## NENI 7

### SIMBOLET E SHOQERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "**MATRIX.AL**" SH.P.K.

## KREU II

## NENI 8

### KAPITALI I SHOQERISE

8. Kapitali i shoqerise "**MATRIX.AL**" SH.P.K, eshte 100.000 leke e cili perbehet nga:

8.1. Kapitali para me vlore te barabarte me 100.000 (nje qindemije ) leke.

8.2. Shoqeria "**MATRIX.AL**" SH.P.K perbehen nga 1 (nje) kuota, me vlore nominale 1 (nje) kuote dhe eshte e barabarte me 100.000 (njeqind mijë) leke.

8.3. Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

## NENI 9

### TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku i Vetem ne favor te te treteve, kryhet gjithnjë me akt notarial te posacem.

9.2. Shoqeria mund te rrise kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnjë jo nen kufirin e 100.000 (njeqind mijë) leke. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise dhe sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

9.3. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për



regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

## **NENI 10**

### **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**10.1.** Kuotat e kapitalit të shoqerise dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**10.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**10.3.** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombëtare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit t". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

## **KREU III**

### **NENI 11**

### **ORGANI VENDIMMARRES**

**11.1.** Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.  
Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**11.2.** Ortaku i Vetem, vendos për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;



- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj;  
h) zmadhimin ose zvogelinin e kapitalit te shoqerise;  
i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

**11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem duhet te regjistrohen në regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:  
a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;  
b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;  
c) investime;  
ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

**11.4.** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

**11.5.** Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## NENI 12

### ADMINISTRATORI

**12.1.** Administratori i shoqerise mund te caktohet edhe një person tjeter, jashte ortakeve.

**12.2.** Administrator i shoqerise vendoset znj. Drilona GERBOLLI.

**12.3.** Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per një afat 4 – vjecar me te drejte riperteritje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

## NENI 13

### KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

**13.1.** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.  
b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;  
c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të



shoqërisë;

ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut te Vetem shoqerise ne mbledhjen e asamblese se ortakve.

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

**13.2.** Administratori eshte i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

**13.3.** Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshir këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevit.

**13.4.** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

**13.5.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

#### **NENI 14**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

#### **NENI 15**

#### **BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET**

**15.1.** Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblese se Përgjithshme, e perbere nga Ortaku i Vetem miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

**15.2.** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e perbere nga Ortaku i vetem vendos



rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e viti te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## NENI 16

### MBARIMI I SHOQERISE

**16.1.** Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Ortakut te Vetem ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

**16.2.** Ne kete rast, Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

**16.3.** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

**16.4.** Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## NENI 17

### TRANSFORMIMI I SHOQERISE

**17.1.** Transformimi i shoqerise behet me vendim te Ortakut te Vetem ose kur ekzistojnë faktore te jashtem detyrues ligjore, ne keto raste vendimi merret pasi i eshte paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

**17.2.** Çdo transformim i bere ne kundershtim me kete nen eshte i pavlefshem.

## NENI 18

### BAZA LIGJORE

**18.1.** Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plotë me kete statut dhe



dispozitat e legjislacionit shqiptar.

**18.2.** Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dale ne zbatim te tyre ne Republiken e Shqiperise.

## NENI 19

### MOSMARREVEESHJET

**19.1.** Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

**19.2.** Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane.

## NENI 20

### DISPOZITA PERFUNDIMTARE

**20.1.** Ky statut eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plete te Ortakut te Vetem dhe eshte nenshkruar prej tij.

**20.2.** Ky Statut u redaktua ne kater kopje, tre ne gjuhen shqipe dhe nje ne gjuhen italiane, me vlera te njejte juridike. Nje kopje mbahet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKU THEMELUES "MATRIX.AL" SH.P.K**

Drilon Gerbolli

Tirane me 23/08/2022

